

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E  
ANKIMIMIT**

**18.08.2025**

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik “R.S.& M” sh.p.k, me NUIS K32203002I me adresë:**  
Autostrada Tiranë – Durrës, km. 2, Tiranë, 1000

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐  
[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO** ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_  
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO** ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_  
[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

\* \* \*

**Lloji i procedurës së prokurimit:** E hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 (dymbëdhjetë) mujor.

**Numri i referencës së procedurës REF 50068-06-03-2025**

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Blerje bojë për sinjalistikë rrugore**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**

Bojra për rrugë 44811000-8

**Fondi limit:** 57,499,603.33 (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është** 584.999,52 (pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje pesëdhjetë e dy) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 03.06.2025 është 98.29.

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër : 12 (dymbëdhjetë) muaj**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:**04.06.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike **Nr. 29 datë 9 Qershor 2025**

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

**1.DEUTSCHCOLOR SH.A NUIS L21326504J, dhe me vlerë të ofruar prej 39,660,300**

(tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind) lekë pa t.v.sh dhe 47,592,360 (dyzet e shtatë milion e pesëqind e nentëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë me t.v.sh .

**2. ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k, NUIS K82230002K dhe me vlerë të ofruar prej 41,753,070 (dyzet e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë) lekë pa t.v.sh dhe 50,103,684 (pesëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) lekë me tvsh**

**3. Signs & Road Safety Solutions shpk NUIS L62228020U dhe me vlerë të ofruar prej 37,375,583 (tridhjetë e shtatë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh dhe 44,850,699.6 (dyzet e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nentëdhjetë e nëntë presje gjashtë) lekë me t.v.sh**

**4. TEKNOKOLOR NUIS K92728401J dhe me vlerë të ofruar prej 36,124,020 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e dyzet mijë e njëzet) lekë pa tvsh dhe 43,348,824 (dyzet e tre milion e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e njëzet e katër) lekë me tvsh.**

**5. R.S & M shpk NUIS K32203002I dhe me vlerë të ofruar prej 49,828,325 (dyzet e nëntë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind njëzet e pesë) lekë pa tvsh dhe 59,793,990 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e tre mijë e nentëqind e nentëdhjetë) lekë me tvsh.**

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori Ekonomik “DEUTSCHCOLOR” SH.A NUIS L21326504J, për arsyet si më posht vijon**

- **OE DEUTSCHCOLOR” SH.A nuk plotëson pikën 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike..... **pasi per BOJE 2K PASTE nuk perputhet te dhënat e kërkuara ne dst me skedën teknike te paraqitur ne SPE dhe skedën teknike te verifikuar nga kontrolli ne WEB.** Per Bojen STRAßEN 80-G SPRAY nuk perputhet te dhënat e kërkuara ne dst me skedën teknike te paraqitur ne SPE dhe skedën teknike te verifikuar nga kontrolli ne ËEB, Per Bojen STRAßEN 80-G nuk perputhet te dhënat e kërkuara ne dst me skedën teknike te paraqitur ne SPE dhe skedën teknike te verifikuar nga kontrolli ne WEB**
- **OE DEUTSCHCOLOR” SH.A nuk plotëson pikën 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 7) në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.....Pasi produktet objekt prokurimi te dorezuara ne momentin e hapjes dhe verifikimit te**

mostrave janë në paketimin Original por disa prej tyre nuk janë të amballazhuara në kova me peshe të percaktuar sipas shenimit në DST (referoju shtojcës 6) .

## 2. Operatori Ekonomik ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k, NUIS

K82230002K për arsyet si më poshtë vijon

- **Operatori Ekonomik ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (referoju shtojcës 7) në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.....Pasi janë paraqitur vetëm një pjesë e mostrave të kërkuara në kete pike të DST.
- **Operatori Ekonomik ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.....Pasi nga analizimi i dokumentacionit ngarkuar në SPE nuk plotësohet % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.
- **Operatori Ekonomik ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike..... Pasi për zerat BOJE BIKOMPONENTE PASTE mungojnë skedat teknike dhe/ose kataloget sipas kërkesës në DST , për zerin fosfor nuk ka dorëzuar të gjithë skeden teknike sipas kërkesës në DST Shtojca 6 dhe për zerin diluent nuk ka paraqitur autorizim prodhues.Për zerat Katalizator pluhur, Leter rulo, Boje vaji, Katalizator leng, Skoc shirit,Furca Rulon qeleshe OE ka futur deklaratë prodhuesi nga OE Bujari sh.a mbështetës por nuk ka paraqitur në SPE skedat teknike sipas kërkesës në DST.

## 3. Operatori Ekonomik Signs& Road Safety Solutions shpk NUIS L62228020U për arsyet si më poshtë vijon:

- **Operatori Ekonomik Signs& Road Safety Solutions shpk nuk plotëson pikën 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.....Pasi nga analizimi i dokumentacionit ngarkuar në SPE (folderat pune të ngjashme 1.2.3.4.5.6.7.8), dhe shqyrtimi i zërave të situacioneve të ngarkuara në SPE rezulton se OE ka paraqitur eksperiencë punimesh të cilat përmbajnë zera në preventiv të ngjashëm me objektin e kësaj procedure, por vlera e tyre e analizuar (sipas manualit të ndërtimit VKM 216 datë 13.04.2023 ) dhe e marrë së bashku nuk plotëson kushtin e % të kërkuara nga AK në DST. Në nenin 4 "Përkufizime", pika 18 e ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar thuhet se: "Kontrata publike furnizimi" janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje, të mallrave. Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen edhe instalimin." Pra nga shqyrtimi i zërave të faturave të ngarkuara në SPE rezulton se OE disponon zera në preventiva të ngjashëm me objektin e kësaj procedure por vlera e tyre e analizuar dhe e marrë së bashku nuk plotëson kushtin e % të kërkuara nga AK në DST. Në këtë kuptim, KVO gjykon, se operatori ekonomik me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon, se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën 40% sipas kërkesës në DST, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, KVO gjykon, se dokumentacioni i paraqitur

nga operatori ekonomik, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

- **Operatori Ekonomik Signs& Road Safety Solutions shpk nuk plotëson 2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike..... **Pasi per BOJE MF21- WHITE nuk perputhet te dhënat e kërkuara ne dst me skedën teknike te paraqitur ne SPE dhe skedën teknike te verifikuar nga kontrolli ne WEB.** Per Bojen SPRAY OE ka paraqitur skedën teknike ne SPE dhe pasi u verifikua nga kontrolli ne WEB nuk gjenden te dhena teknike sipas atyre te paraqitura ne SPE.

#### **4. Operatori Ekonomik TEKNOKOLOR NUIS K92728401J për arsyet si më poshtë vijon;**

- **Operatori Ekonomik TEKNOKOLOR NUIS K92728401J nuk plotëson piken 2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë për bojrat, fosforin dhe diluentin, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike..... **pasi OE nuk ka paraqitur katalogun dhe/ose skedat teknike per produktet e kerkuara ne DST**
- **Operatori Ekonomik TEKNOKOLOR NUIS K92728401J nuk plotëson piken 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi (**referoju shtojcës 7**) në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.....**Pasi nuk ka paraqitur asnjë nga mostrat pjese e DST.**
- **Operatori Ekonomik TEKNOKOLOR NUIS K92728401J nuk plotëson piken 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se malli objekt prokurimi do të jetë i prodhuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)..... **Pasi OE nuk ka paraqitur deklaratën sipas kerkeses ne DST.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

**“R.S.& M” sh.p.k,** me NUIS K32203002I 49,828,325 (dyzet e nëntë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e treqind njëzet e pesë) lekë pa tvsh dhe 59,793,990 (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e tre mijë e nentëqind e nentëdhjetë) lekë me tvsh.

**Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTAKTOR**